

Analizë e Programit të Qeverisë së Kosovës 2021-2025



Analizë e Programit të Qeverisë së Kosovës 2021-2025

TITULLI:

Analizë e Programit të Qeverisë së Kosovës 2021-2025

AUTOR:

Lëvizja FOL

VITI I BOTIMIT:

2025

WEBSITE:

www.levizjafol.org

ADRESA:

Andrea Gropa nr.35, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

* Ky publikim është financuar nga Rockefeller Brothers Fund. Përmbajtja e tij si dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Rockefeller Brothers Fund.

Të drejtat e autorit © 2025. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem rikthimi, ose transmetohet, në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, incizues ose ndryshe, pa pëlqimin paraprak me shkrim të botuesit.

Përmbajtja

1. Hyrje	7
2. Metodologjia	10
Sektori i Shëndetësisë	11
Sektori i Drejtësisë	14
Reformat në financa publike dhe prokurim publik	22
Ekonomia dhe Rimëkëmbja	23
Sektori i Edukimit	24
Politika e Jashtme	25
Përfundim	28

1. Hyrje

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2021-2025,¹ miratuar më 7 maj 2021, paraqiti një vizion ambicioz për zhvillimin ekonomik, social dhe institucional të vendit. Megjithatë, zbatimi i këtij programi është përballur me sfida serioze që kanë penguar arritjen e objektivave kryesore. Ndër sfidat kryesore janë vonesat në miratimin e politikave, defektet legjislative dhe mungesa e koordinimit ndër-institucional.

Programi i Qeverisë ka paraparë dy prioritet kryesore të asaj kohe që kanë qenë menaxhimi i pandemisë COVID 19 dhe ringjallja ekonomike. Kurse, sa i përket aspektit sektorial, Programi i Qeverisë është i ndarë në 18 prioritete, ku përfshihen: Shëndeti publik dhe mbrojtja sociale, Sundimi i ligjit, Rendi dhe siguria publike, Qeverisja, Të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore, Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të komuniteteve, Rritje gjithëpërfshirëse ekonomike, Industria, ndërmarrësia dhe tregtia, Zhvillimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve të TIK, Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural, Zhvillimi rajonal, Mjedisi dhe Planifikimi Hapësinor, Infrastruktura, Energjia dhe minierat, Arsimi dhe shkenca, Kultura, Rinia dhe Sporti, Politika e jashtme dhe diaspora, Politikat e mbrojtjes.

Në mënyrë që të zbatohet Programi, Qeveria është dashur të ndërmarrë veprime për miratimin e ligjeve si hapa paraprakë në zbatim të programit. Megjithatë, një nga problemet më të dukshme ka qenë vonesa në miratimin dhe zbatimin e ligjeve. Një numër i madh projektligjesh të miratuara nga Kuvendi i Kosovës janë kontestuar për shkelje procedurale dhe janë dërguar në Gjykatën Kushtetuese. Për shembull, në dhjetor 2024, një grup deputetësh dorëzoi 16 projektligje në Gjykatën Kushtetuese, duke e akuzuar qeverinë për mosrespektim të procedurave ligjore.²

Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar gjithashtu disa ligje të rëndësishme, duke i konsideruar ato në kundërshtim me Kushtetutën. Ndër to janë Ligji për Byronë e Konfiskimit të Pasurisë së Pajustificueshme dhe Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, të cilat konsideroheshin kyçe për reformën në sundimin e ligjit. Shfuqizimi i këtyre ligjeve ka nxjerrë në pah jo vetëm mungesën e përgatitjes teknike të qeverisë, por edhe dobësinë në sigurimin e një konsensusi më të gjerë politik dhe institucional për miratimin e tyre.

Një tjetër sfidë madhore ka qenë mungesa e koordinimit ndër-institucional, e cila ka ndikuar negativisht në harmonizimin e veprimeve ndërmjet institucioneve të ndryshme. Kjo është parë veçanërisht në vonesat për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe krijimin e Fondit Sovran, dy projekte që do të kishin qenë vendimtare për përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Për më tepër, sfida të ngjashme janë evidentuar në sektorë strategjikë si shëndetësia, arsimi dhe politika e jashtme, ku mungesa e një qasjeje të mirë organizuar ka frenuar avancimin e reformave të planifikuara.

1 <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>

2 Levizja FOL, "Aksham Pazari" – Ligjvënja e përshpejtuar në Kuvendin e Kosovës, <https://levizjafol.org/aksham-pazari-ligjvjenja-e-pershpejtuar-ne-kuvendin-e-kosoves/>

Sundimi i ligjit, i konsideruar një prioritet kyç në programin qeverisës, ka hasur gjithashtu në pengesa të mëdha. Procesi i vettingut, i prezantuar si një masë për pastrimin e sistemit të drejtësisë, nuk ka arritur të kalojë fazën fillestare, duke reflektuar mungesën e një strategjie të qartë dhe vullnetit politik për zbatimin e tij. Për më tepër, përgatitja e padisë për gjenocid kundër Serbisë është promovuar gjerësisht nga qeveria, por deri më tani nuk ka treguar ndonjë progres konkret dhe ka mbetur më shumë si një nismë retorike.

Në përmbledhje, programi qeverisës për 2021-2025 ka dështuar të realizojë objektivat e tij kryesore për shkak të ngecjeve procedurale, mungesës së përgatitjes teknike dhe mungesës së koordinimit institucional.

Ky raport, në vijim, do të trajtojë sektorët kryesorë të programit qeverisës dhe objektivat kyçe që kanë dalë nga këto sektorë. Diskutimi do të përqendrohet në sfidat dhe mangësitë që kanë penguar realizimin e tyre, duke përfshirë problematikat në sundimin e ligjit, zhvillimin ekonomik, arsimin, shëndetësinë dhe politikën e jashtme. Analiza synon të identifikojë pengesat kryesore, si dhe të ofrojë rekomandime për përmirësimin e qasjes institucionale dhe përmbushjen e pritjeve të qytetarëve.

2. Metodologjia

Analiza e sektorëve është kryer duke marrë parasysh rëndësinë strategjike të tyre për zhvillimin e Kosovës dhe ndikimin në mirëqenien e qytetarëve, bazuar në prioritetet e përcaktuara nga Qeveria e Kosovës në Programin 2021-2025.

- Sektori i shëndetësisë dhe ai i arsimit janë trajtuar me kujdes, pasi përbëjnë shtyllat themelore në lidhje me vitalitetin e shoqërisë. Shëndetësia është analizuar pasi që reflekton gjendjen aktuale të qytetarëve sa i përket mirëqenies shëndetësore, ndërsa arsimit është analizuar pasi që reformat e ndërmarrë nga Qeveria krijojnë bazamentin e zhvillimit dhe përparimin afatgjatë në të ardhmen.
- Sektorit të Drejtësisë i është kushtuar rëndësi e veçantë duke marrë për bazë gjendjen në sektorin e sundimit të ligjit dhe reformimin institucional, sidomos në raport me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës.
- Gjithashtu, është analizuar politika e jashtme e Kosovës, duke u ndalur në sfidat e vazhdueshme për përmirësimin e statusit ndërkombëtar, integrimin në organizata ndërkombëtare dhe sigurimin e njohjeve të reja me theks në dështimin më kolosal gjatë këtij mandati qeverisës e që është mos anëtarësimi në Këshillin e Evropës.
- Ekonomia është përfshirë në analizë për shkak të premtimeve ambicioze për zhvillim dhe rimëkëmbje, të cilat megjithatë janë shoqëruar me ngecje të theksuara në zbatimin e politikave përkatëse. Këto përfshijnë mosrealizimin e reformave thelbësore, si ligjet për Fondin Sovran dhe Bankën Zhvillimore, si dhe mos shuarjen e Agjencisë Kosovare për Privatizim. Administrata publike dhe digjitalizimi janë trajtuar si fusha me potencial për rritjen e efikasitetit dhe transparencës institucionale. Megjithatë, përpjekjet për digjitalizimin e shërbimeve mbeten të kufizuara, duke ndikuar negativisht në qasjen e qytetarëve dhe bizneseve ndaj shërbimeve cilësore.

Sektorët e përzgjedhur janë analizuar jo vetëm për rëndësinë e tyre strategjike, por edhe për sfidat që kanë penguar zbatimin e reformave dhe masave përkatëse. Qëllimi i kësaj analize është të nxjerrim në pah jo vetëm dështimet, por edhe mundësitë për reforma dhe zhvillim më efektiv në të ardhmen.

Kjo analizë është bërë dukë u bazuar në informacionet e përgjithshme të cilat janë publikisht të qasshme, në faqe zyrtare të institucioneve publike, nga raportet e organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile në Kosovë.

Më poshtë, analiza trajton objektivat dhe nën objektivat e Qeverisë në formë tabelare, derisa shkalla e realizmit të objektivave i është nënshtruar vlerësimit si më poshtë:

**DËSHTIM**

Kur Qeveria nuk ka arritur as të miratojë dhe as të zbatojë ligjin apo dokumentin e politikave përkatëse, duke treguar mungesë të përpjekjeve konkrete ose dështim të plotë të procesit.

**NË PROCES**

Kur Qeveria ka miratuar ligjin apo dokumentin e politikave, por nuk ka arritur ta zbatojë.

**E REALIZUAR**

Kur Qeveria ka miratuar dhe ka zbatuar ligjin apo dokumentin e politikave përkatëse, duke përmbushur qëllimet e përcaktuara.

**E REALIZUAR
ME VONESË**

Kur Qeveria ka miratuar dhe zbatuar ligjin apo dokumentin e politikave përkatëse vetëm gjatë muajve të fundit të mandatit katërvjeçar, duke treguar neglizhencë dhe duke dëshmuar se një veprim i tillë nuk ka qenë prioritet i saj gjatë mandatit.

Sektori i Shëndetësisë

**PRIORITETI
QEVERITAR**

GJENDJA FAKTIKE

**SHKALLA E
REALIZIMIT**

STRATEGJIA E RE E SHËNDETËSISË

*(2.1.1 Reformimi
i sektorit të
shëndetësisë, fq. 10)*

Strategjia e Shëndetësisë 2025-2030 u miratua vetëm në pjesën e fundit të mandatit të qeverisë, në nëntor të vitit 2024, duke humbur katër vite të vlefshme për planifikim dhe zbatim të reformave në shëndetësi. Kjo vonesë tregon mungesë serioziteti në priorizimin e shëndetësisë si një nga shtyllat kryesore të qeverisjes.

Mos aprovimi në kohë i Strategjisë së Shëndetësisë ka krijuar pasoja të konsiderueshme për zhvillimin e sektorit të shëndetësisë. Vonesa prej katër viteve në miratimin e saj ka përjashtuar mundësinë për të pasur një udhëzues strategjik në një periudhë të rëndësishme për planifikimin dhe zbatimin e reformave. Ky boshllëk ka reflektuar mungesën e një qasjeje të strukturuar dhe të koordinuar nga institucionet për të adresuar sfidat në sektorin e shëndetësisë.

Gjatë kësaj periudhe, shëndetësia ka mbetur pa orientimin e nevojshëm për zhvillim, duke i lënë aktorët kryesorë në një gjendje stagnimi dhe improvizimi. Pa strategjinë si pikë referimi, politikat dhe iniciativat në shëndetësi janë zhvilluar në mënyrë të fragmentuar, shpesh duke anashkaluar reformat strukturore të domosdoshme. Për shembull, investimet në infrastrukturë dhe teknologji janë shtyrë ose janë realizuar pa një plan të mirë përcaktuar, duke penguar avancimin e sistemit të shërbimeve mjekësore dhe qasjen e qytetarëve në shërbime cilësore.

Gjithashtu, vonesa ka penguar zbatimin e reformave për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe përmirësimin e kushteve të punës për profesionistët shëndetësorë, një çështje kyçe për ruajtjen e një sistemi të qëndrueshëm. Kjo ka krijuar një situatë ku sfidat ekzistuese janë thelluar dhe qytetarët kanë vazhduar të përballen me mangësi në shërbimet shëndetësore, përfshirë kohëzgjatjen e gjatë të pritjes dhe cilësinë e ulët të trajtimit në disa institucione.

Në miratimin e vonuar të strategjisë, vetëm në fund të mandatit të qeverisë, reflektohet mungesa e seriozitetit dhe e priorizimit të shëndetësisë si një shtyllë kryesore e qeverisjes. Kjo jo vetëm që ka vonuar reformat, por ka dëmtuar edhe besimin e publikut në angazhimin institucional për të garantuar një sistem shëndetësor të qasshëm dhe të përmirësuar për të gjithë qytetarët.

**E REALIZUAR
ME VONESË**

**PRIORITETI
QEVERITAR**

GJENDJA FAKTIKE

**SHKALLA E
REALIZIMIT**

**LIGJI PËR SIGURIME
SHËNDETËSORE**

*(Sigurime
shëndetësore publike,
fq. 10)*

Ligji për Sigurimet Shëndetësore në Kosovë ka qenë një nismë e zvarritur për vite me radhë, duke reflektuar sfidat e vazhdueshme në reformimin e sistemit shëndetësor. Pavarësisht se ka qenë një prioritet i shpallur nga qeveritë e njëpasnjëshme, edhe kjo qeveri nisi mandatin me premtimin se sigurimi shëndetësor do të bëhej realitet. Megjithatë, pas katër vitesh qeverisjeje, ligji u miratua vetëm më 5 dhjetor 2024, në fund të mandatit, pas një procesi të stërzgjatur dhe me mungesë të dukshme të vullnetit politik për ta shtyrë përpara këtë reformë kaq të rëndësishme.

Këto vonesa kanë pasur pasoja të ndjeshme në funksionimin dhe zhvillimin e sektorit shëndetësor. Kosova mbetet pa një skemë funksionale të sigurimeve shëndetësore dhe pa një mekanizëm të qëndrueshëm për financimin e shërbimeve, duke i lënë qytetarët të përballen me kosto të larta nga xhepi dhe me një sistem që nuk i plotëson nevojat e tyre bazike.

Një nga pasojat kryesore të kësaj vonese është mos krijimi në kohë i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, i cili do të duhej të siguronte bazën financiare për mbulimin e shërbimeve shëndetësore dhe lehtësimin e barrës ekonomike për qytetarët. Në mungesë të mbulimit financiar, qytetarët janë detyruar të përballojnë kosto të larta nga xhepi për kujdesin shëndetësor, duke ndikuar drejtpërdrejt në qasjen e tyre ndaj shërbimeve bazë, veçanërisht për grupet më të cenueshme. Për më tepër, mosfunksionalizimi i skemës ka lënë të pambuluara shumë nga reformat strukturore të domosdoshme për përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor dhe modernizimin e sistemit. Moszbatimi i sistemit të sigurimeve shëndetësore ka ndikuar që Kosova të mbetet ndër vendet e pakta në rajon dhe Evropë pa një skemë funksionale të sigurimeve, duke e larguar edhe më shumë nga përmbushja e standardeve ndërkombëtare në kujdesin shëndetësor.

Pas miratimit të vonuar, ligji tani është dërguar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës për shqyrtim, si rezultat i kundërshtimeve nga disa deputetë të Kuvendit. Ky proces ka krijuar një situatë ku edhe pas miratimit të ligjit, e ardhmja e zbatimit të tij mbetet e pasigurt.

**E REALIZUAR
ME VONESË**

**PRIORITETI
QEVERITAR**

GJENDJA FAKTIKE

**SHKALLA E
REALIZIMIT**

**LIGJI PËR
SHËNDETËSINË**

(Riorganizimi i sektorit të shëndetësisë, fq. 10)

Një nga dështimet më të mëdha të qeverisë është mungesa e miratimit të Ligjit për Shëndetësinë, i cili konsiderohet një ndër iniciativat më të rëndësishme për reformimin e sektorit shëndetësor në Kosovë. Pas shumë vonesash dhe shtyrjesh, Ministria e Shëndetësisë e ka paraqitur projektligjin për konsultime publike nga data 24 tetor deri më 13 nëntor 2024, vetëm në fund të mandatit qeverisës. Ky hap shihet kryesisht si një manovër taktike, pasi është e qartë se projektligji nuk ka gjasa të kalojë në Kuvend brenda këtij mandati.

Edhe pse për vite me radhë, sektori i shëndetësisë në Kosovë ka operuar pa një kornizë të përditësuar ligjore, duke u mbështetur në akte të vjetruara që nuk pasqyrojnë nevojat aktuale apo praktikat më të mira ndërkombëtare Qeveria nuk ka ndërmarrë hapa të duhur duke e lënë sektorin pa udhëzime të qarta dhe pa një drejtim strategjik.

Pasojat e këtyre vonesave janë të dukshme. Për shumë vite, reformat në shëndetësi kanë mbetur të bllokuara, ndërsa qytetarët përballen me sfida në qasje ndaj shërbimeve cilësore. Institucionet shëndetësore, si publike ashtu edhe private, operojnë në një mjedis të paqartë ligjor, gjë që ndikon negativisht në efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve që ofrojnë.

DËSHTIM

**SISTEMI UNIK
DHE I INTEGRUAR
I INFORMIMIT
SHËNDETËSOR**

(Riorganizimi i sektorit të shëndetësisë, fq. 10)

Pavarësisht se digjitalizimi i sistemit shëndetësor u identifikua si një prioritet për përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve, nuk pati progres të dukshëm në këtë drejtim. Ministria e Shëndetësisë dështoi të zhvillojë dhe operacionalizojë një sistem të unifikuar të informimit shëndetësor, i cili do të mundësonte menaxhimin e referimeve, mbledhjen dhe analizën e të dhënave epidemiologjike, si dhe përmirësimin e komunikimit midis institucioneve shëndetësore. Ky dështim ka lënë sistemin shëndetësor të Kosovës të mbështetet në procese manuale dhe të fragmentuara, duke penguar avancimin drejt një shërbimi më efikas dhe të bazuar në të dhëna.

DËSHTIM

Sektori i Drejtësisë

PRIORITETI QEVERTAR

GJENDJA FAKTIKE

SHKALLA E REALIZIMIT

PROCESI I VETINGUT NË GJYQËSOR DHE PROKURORI

(2.2.1 Përmirësimi
i integritetit të
institucioneve të
drejtësisë, fq. 12)

Procesi i *vettingut* në Kosovë është shfaqur si një nga temat më të rëndësishme të diskutimeve për reformën në drejtësi gjatë viteve 2021-2024. Megjithatë, mungesa e rezultateve konkrete dhe dështimi për ta vënë në praktikë këtë proces e ka kthyer atë në një premtim bosh të qeverisë aktuale, e cila ka dështuar të kalojë nga fjalët në veprime të qëndrueshme.

Në tetor të vitit 2021, Ministria e Drejtësisë i kërkoi Komisionit të Venecias të japë një opinion mbi një koncept dokument që synonte nisjen e procesit të *vettingut*. Edhe pse kjo lëvizje u paraqit si një hap i rëndësishëm, rezultati mbeti në nivel teorik. Në qershor të vitit 2022, Komisioni i Venecias publikoi opinionin e tij, duke mbështetur idenë e një procesi *vettingu*, por njëkohësisht paralajmëroi për kujdes të madh për të shmangur ndikime negative mbi pavarësinë e sistemit gjyqësor. Përkundër këtyre udhëzimeve, qeveria nuk arriti të formulojë një strategji bindëse për t'i dhënë drejtim këtij procesi.

Në shtator të vitit 2022, qeveria dorëzoi në Kuvend një pako dokumentesh, përfshirë amendamentet kushtetuese dhe draft-ligjet për *vettingun*, të cilat u prezantuan si "Dosja e *Vettingut*". Megjithatë, kjo pako mbeti në letër për shkak të mungesës së koordinimit politik dhe kundërshtive të shumta brenda Kuvendit. Qeveria nuk arriti të sigurojë përfshirje dhe përkrahje të gjerë nga deputetët dhe aktorët kyç, duke shkaktuar vonesa të mëtejshme.

Në mars të vitit 2023, amendamentet iu referuan Gjykatës Kushtetuese, e cila konfirmoi disa elemente si të përshtatshme, por ngriti shqetësime për aspekte të tjera, përfshirë përkufizimin e termave si "integritet i cenueshëm". Ky vendim theksoi rëndësinë e gjetjes së një bilanci midis reformave dhe mbrojtjes së të drejtave kushtetuese, por qeveria nuk arriti të përmbushë këto rekomandime.

Në shkurt të vitit 2024, amendamentet u paraqitën për diskutim në Kuvend, por bojkotet nga deputetët e komuniteteve jo-shumicë dhe mungesa e kuorumit çuan në bllokimin e procesit. Ky dështim i qeverisë për të ndërtuar një konsensus politik nxori në pah mungesën e vizionit dhe aftësisë për të çuar përpara një reformë kaq të rëndësishme.

Deri në fund të vitit 2024, procesi i *vettingut* në Kosovë nuk ka kaluar as në fazën fillestare të zbatimit praktik. Mbështetja nga partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat e shoqërisë civile ka qenë e dukshme, por mungesa e vendosmërisë nga qeveria dhe ngecja në miratimin e amendamenteve kushtetuese e ka bërë këtë proces të duket më shumë si një premtim politik i paplotësuar sesa një përpjekje serioze për reformë.

Në vend që të jetë një hap përpara drejt reformës në drejtësi, procesi i *vettingut* ka reflektuar mungesën e vullnetit dhe aftësisë së qeverisë për të adresuar problemet e sistemit gjyqësor. Pa një përfshirje të gjerë të akterëve vendorë dhe ndërkombëtarë dhe pa një strategji të mirë përcaktuar, ky proces rrezikon të mbetet një dështim i madh i kësaj qeverie. Ndërkohë, qytetarët dhe sistemi i drejtësisë vazhdojnë të vuajnë pasojat e mungesës së veprimit konkret.

NË PROCES

**PRIORITETI
QEVERITAR**
GJENDJA FAKTIKE
**SHKALLA E
REALIZIMIT**
**STRATEGJIA PËR
SUNDIMIN E LIGJIT**

(2.2.1 Përmirësimi i integritetit të institucioneve të drejtësisë, fq. 12)

Në vitin 2021, Kosova shënoi një hap të rëndësishëm drejt reformave të thella në drejtësi me miratimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit për periudhën 2021-2026. Kjo strategji ishte rezultat i një procesi të gjatë konsultimesh dhe analizash që pasuan Rishikimin Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, duke synuar të adresohen sfidat kyçe të sistemit të drejtësisë dhe të forcohet integriteti institucional.

Strategjia përfshinte objektiva të qarta për fuqizimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, luftën kundër korrupsionit dhe përmirësimin e qasjes në drejtësi. Për të arritur këto qëllime, u hartua një Plan Veprimi për periudhën 2021-2023, i cili përmbante masa specifike dhe afate të përcaktuara.

Në vitin 2022, zbatimi i strategjisë hasi në pengesa. Një raport i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) tregoi se vetëm 43% e aktiviteteve të planifikuara për atë vit u realizuan plotësisht, ndërsa një pjesë e konsiderueshme u realizuan vetëm pjesërisht ose mbetën të pazbatuara. Pengesat kryesore përfshinin mungesën e koordinimit ndërinstitutional dhe fondet e pamjaftueshme për zbatimin e masave të parashikuara.

Në vitin 2023, situata nuk ndryshoi në mënyrë domethënëse. Përqindja e aktiviteteve të përfunduara ra në 41%, dhe një pjesë edhe më e madhe e aktiviteteve mbeti e pazbatuar. Kjo periudhë tregoi qartë se procesi kishte ngecur dhe kërkonte një angazhim më të madh nga institucionet përgjegjëse.

Në fillim të vitit 2024, ishte parashikuar një rishikim afatmesëm i strategjisë për të vlerësuar progresin dhe për të përcaktuar prioritetet për periudhën e mbetur deri në vitin 2026. Megjithatë, ky proces u vonua, dhe drafti i rishikimit u publikua për konsultim publik vetëm në tetor 2024. Kjo vonesë ndikoi negativisht në zbatimin e masave të planifikuara për atë vit dhe la strategjinë pa një plan të qartë veprimi për pjesën e mbetur të periudhës.

Mungesa e buxhetit të mjaftueshëm dhe koordinimi i dobët ndërmjet institucioneve mbetën sfidat kryesore gjatë gjithë periudhës. Përveç këtyre, edhe mekanizmat e monitorimit dhe raportimit rezultuan të jenë joefikasë, duke vështirësuar ndjekjen e progresit dhe identifikimin e pengesave në kohë.

Megjithatë, Strategjia për Sundimin e Ligjit mbetet një kornizë e rëndësishme për reformat në drejtësi. Angazhimi i partnerëve ndërkombëtarë dhe presioni i shoqërisë civile kanë qenë elementë të rëndësishëm që kanë mbajtur të gjallë diskutimin për nevojën e përbushjes së objektivave të saj. Për të siguruar suksesin e kësaj strategjie deri në vitin 2026, institucionet përgjegjëse duhet të përqendrohen në përmirësimin e kapaciteteve zbatuese, rritjen e transparencës dhe alokimin e burimeve të nevojshme. Strategjia mbetet një bazë e fortë, por kërkon përkushtim më të madh dhe hapa konkretë për të përbushur pritjet e qytetarëve të Kosovës.

**Miratimi i
Strategjisë**

**Rishikimi i
Strategjisë**


**PRIORITETI
QEVERITAR****GJENDJA FAKTIKE****SHKALLA E
REALIZIMIT****KODI I PROCEDURËS
PENALE**

(2.2.2 Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative, fq. 13)

Gjatë periudhës 2021-2024, Kosova ndërmori reforma të rëndësishme në drejtësi, përfshirë ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, të cilat synonin ta bënë sistemin më efikas dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, këto ndryshime u shoqëruan me sfida dhe pasoja që ngjallën debat publik dhe institucional.

Në gusht të vitit 2021, qeveria prezantoi një projekt për ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale, duke e publikuar për konsultime publike. Ky dokument synonte të adresonte disa boshllëqe që ishin evidentuar në praktikë, duke përmirësuar procedurat për çështje të ndjeshme si masat e sigurisë dhe lirimi me kusht.

Pas konsultimeve dhe rishikimeve, në tetor 2022, qeveria miratoi një projektligj të ndryshuar, i cili më vonë kaloi për miratim në Kuvend. Në tetor 2023, Kuvendi miratoi ndryshimet e propozuara, duke theksuar nevojën për të forcuar masat kundër krimeve të rënda dhe përmirësimin e qasjes në drejtësi. Ndërsa këto ndryshime synonin të përmirësonin sistemin, disa dispozita shkaktuan debat për efektet e tyre të mundshme, veçanërisht ato që lidheshin me kushtet për lirin nga paraburgimi.

Një nga rastet që lidhet drejtpërdrejt me këto ndryshime ishte ai i Enver Sekiraqës, një emër i njohur në Kosovë, i cili u akuzua për nxitje në vrasjen e policit Triumf Riza. Në maj të vitit 2024, Gjykata Themelore në Prishtinë e dënoi Sekiraqën me 25 vite burgim. Megjithatë, disa javë pas këtij vendimi, Sekiraqa u lirua nga paraburgimi nga një vendim i gjykatës, por që bazohej në dispozitat e reja të Kodit të Procedurës Penale. Ky librim u edhe pse u konsiderua i papërshtatshëm nga shumë aktorë të drejtësisë dhe shoqërisë civile, u kritikua edhe Qeveria e cila përmes ndryshimeve në Kod i dha edhe mundësi ligjore arratisjes së tij.

Ky rast vuri në pah sfidat që lidhen me zbatimin e ndryshimeve në legjisllacionin penal dhe pasojat e mundshme të tyre. Edhe pse ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale kishin për qëllim forcimin e drejtësisë, rasti i Enver Sekiraqës ngriti pyetje serioze për efikasitetin dhe ndikimin e tyre në praktikë. Kky rast tregon se ndryshimet ligjore duhet të shoqërohen me zbatim të kujdesshëm dhe analiza të thelluara të ndikimit të tyre. Nëse këto sfida nuk adresohen, besimi i qytetarëve në sistemin e drejtësisë rrezikon të dobësohet më tej.

E REALIZUAR

**PRIORITETI
QEVERITAR****GJENDJA FAKTIKE****SHKALLA E
REALIZIMIT****KORNIZA LIGJORE
PËR ÇËSHTJEN E
PASURISË SË FITUAR
NË MËNYRË TË
PAJUSTIFIKUESHME**

(2.2.2 Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative, fq. 13)

Në përpjekje për të adresuar problemin e pasurive të pajustificueshme dhe për të forcuar luftën kundër korrupsionit, Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë së Drejtësisë, nisi një proces të gjerë për hartimin e Ligjit për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Ky proces filloi me hartimin e një koncept-dokumenti mbi konfiskimin civil, i cili pas miratimit nga Qeveria u bë baza për hartimin e një projektligji gjithëpërfshirës. Në hartimin e këtij projektligji u përfshinë përfaqësues nga sistemi i drejtësisë, përfshirë Gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Apelit, si dhe partnerë ndërkombëtarë si Zyra e Bashkimit Evropian, Ambasada e SHBA, OSBE, UNDP dhe ekspertë të pavarur.

Pas përfundimit të draftit, projektligji u dërgua në Qeveri dhe më pas në Kuvend për miratim. Kuvendi i Kosovës, duke synuar të sigurojë përputhshmëri me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare, e përcolli projektligjin për shqyrtim në Komisionin e Venecias. Në qershor të vitit 2022, Komisioni i Venecias publikoi opinionin e parë për projektligjin, duke vlerësuar përpjekjet e Qeverisë, por duke dhënë edhe rekomandime për përmirësime. Pas këtij opinionin, Kuvendi, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe një grup punues të përbërë nga përfaqësues të institucioneve, organizatave civile dhe partnerëve ndërkombëtarë, adresoi të gjitha vërejtjet dhe bëri ndryshimet e nevojshme në projektligj. Për të shmangur çdo paqartësi, Kuvendi iu drejtua sërish Komisionit të Venecias, i cili në dhjetor 2022 dha një opinion të dytë, duke vlerësuar se ndryshimet kishin adresuar shumicën e rekomandimeve fillestare.

Pas këtij procesi të gjatë, Kuvendi i Kosovës miratoi projektligjin në leximin e dytë më 9 shkurt 2023, por që u pasua me një kërkesë të një grupi deputetësh për vlerësim të kushtetutshmërisë nga në Gjykatën Kushtetuese. Në korrik të vitit 2024, Gjykata Kushtetuese shpalli ligjin të pavlefshëm, duke argumentuar se disa dispozita nuk ishin në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Pas vendimit të Gjykatës, Ministria e Drejtësisë filloi procesin e hartimit të ligjit. Për shkak të afateve të ngushta, Kryeministri miratoi një kërkesë për shmangie nga disa procedura të zakonshme të konsultimeve publike, duke mundësuar përshpejtimin e procesit. Kjo vendimmarrje nxiti reagime nga organizatat e shoqërisë civile, të cilat kritikuan Qeverinë për mungesë të konsultimeve transparente dhe gjithëpërfshirëse. Sipas këtyre organizatave, shmangia e konsultimeve me publikun dhe shoqërinë civile kufizoi mundësinë për të adresuar shqetësimet dhe për të përmirësuar më tej draftin e projektligjit.

Më 11 shtator 2024, Qeveria miratoi versionin e ri të projektligjit dhe e përcolli atë në Kuvend, ku më 5 dhjetor 2024 u miratua në të dy leximet.

Megjithatë, edhe kësaj radhe një grup deputetësh e kanë dërguar prap për vlerësim të kushtetutshmërisë nga në Gjykatën Kushtetuese dhe se si rrjedhojë mund të konkludohet se qevria ka dështuar në arritjen e kësaj objektive specifike.

NË PROCES

**PRIORITETI
QEVERITAR**
GJENDJA FAKTIKE
**SHKALLA E
REALIZIMIT**
**MEKANIZMI I
VEÇANTË PËR
LUFTIMIN E KRIMIT
TË ORGANIZUAR DHE
KORRUPSIONIT TË
NIVELIT TË LARTË**

(2.2.2 Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative, fq. 13)

Qeveria e Kosovës ndryshoi Ligjin për Prokurorinë Speciale, duke përfshirë dispozita që detyronin krijimin e një njësie të posaçme brenda Policisë së Kosovës, të dedikuar ekskluzivisht për trajtimin e rasteve të ndjeshme të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar. Ky mekanizëm i veçantë synonte t'i mundësonte Prokurorisë Speciale një qasje më efektive dhe të drejtpërdrejtë në hetime, duke kapërcyer pengesat e deritanishme të hierarkisë komanduese brenda Policisë.

Kjo strukturë e re u konceptua si një njësi e përqendruar, që do të vepronte nën drejtimin dhe koordinimin e Prokurorisë Speciale. Objektivi kryesor ishte rritja e pavarësisë operacionale dhe përmirësimi i efikasitetit në trajtimin e rasteve komplekse dhe të ndjeshme, që deri tani janë përballur me vonesa dhe pengesa institucionale. Ky hap përfaqësonte një përpjekje për të adresuar dobësitë e evidentuara në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke krijuar një mekanizëm të dedikuar dhe të strukturuar për këtë qëllim.

Megjithatë, deri në momentin e shkrimit të këtij raporti, **njësia ende nuk është themeluar**. Kjo vonesë ka ardhur si rezultat i shqetësimeve të ngritura nga akterë të ndryshëm për ndikimin që kjo njësi do të kishte në strukturën komanduese të Policisë së Kosovës. Është ngrit shqetësimi se njësia e posaçme, për shkak të varësisë së saj të drejtpërdrejtë nga Prokuroria Speciale, do të shkëputej nga zinxhiri tradicional komandues i Policisë, duke krijuar një model të ri që do të ndryshonte ndjeshëm mënyrën e funksionimit praktik të Policisë dhe varësisë se saj ndaj Prokurorisë Speciale.

Themelimi dhe funksionalizimi i kësaj njësie duhet të mbetet një prioritet që kërkon vendimmarrje të guximshme dhe koordinim të ngushtë midis Qeverisë, Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë Speciale për të siguruar suksesin e saj në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.


DËSHITIM
**GJYKATA
KOMERCIALE**

(2.2.2 Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative, fq. 13)

Themelimi i Gjykatës Komerciale në Kosovë shënoi një hap të rëndësishëm në përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe trajtimin e rasteve komerciale. Ministria e Drejtësisë dhe Qeveria luajtën një rol themelor në fazën fillestare, duke hartuar dhe promovuar Ligjin për Gjykatën Komerciale, i cili u miratua në vitin 2022. Ky ligj përcaktoi bazën ligjore për funksionimin e gjykatës, por përgjegjësia për pjesën operacionale dhe vënie në funksion të Gjykatës është kompetencë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

KGJK udhëhoqi procesin e organizimit dhe funksionalizimit të Gjykatës, duke përfshirë përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe krijimin e infrastrukturës. Në këtë proces, ndihma teknike dhe financiare e USAID-it ishte jetike, duke mbështetur KGJK-në në trajnime dhe pajisje. Si rrjedhojë, roli i Ministrisë dhe Qeverisë ishte minimal pas miratimit të ligjit.

Gjykata filloi punën në vitin 2023 dhe pritet të kontribuojë në përmirësimin e klimës së biznesit në Kosovë.


REALIZUAR

**PRIORITETI
QEVERITAR****GJENDJA FAKTIKE****SHKALLA E
REALIZIMIT****GJYKATA
ADMINISTRATIVE DHE
GJYKATA E PUNËS**

(2.2.2 Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative, fq. 13)

Themelimi i Gjykatës Administrative dhe Gjykatës së Punës ka qenë pjesë e planit të reformave në sistemin e drejtësisë në Kosovë, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe adresimin e specializuar të çështjeve administrative dhe marrëdhënieve të punës. Megjithatë, këto reforma nuk janë realizuar brenda afateve të parashikuara, duke krijuar një boshllëk të ndjeshëm në trajtimin e këtyre rasteve.



Ligji për Gjykatën Administrative u procedua nga qeveria në vitin e fundit qeverisës dhe u miratua më 5 dhjetor 2024, por aktualisht gjendet për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese. Kjo vonesë ka lënë një vakum në trajtimin e rasteve administrative, të cilat ende shqyrtohen nga gjykatat themelore, të cilat shpeshherë përballen me ngarkesë të lartë pune dhe mungesë të ekspertizës së specializuar për çështje administrative. Kjo situatë ka ndikuar negativisht në qasjen e qytetarëve dhe bizneseve në drejtësi administrative.

Sa i përket Gjykatës së Punës, nuk janë ndërmarrë hapa konkretë për draftimin ose miratimin e një ligji për krijimin e saj. Edhe pse nevoja për një Gjykatë të Punës është diskutuar shpesh, sidomos duke pasur parasysh prioritetin që qeveria i ka dhënë çështjeve të punësimit, mosveprimi në këtë drejtim ka lënë çështjet e marrëdhënieve të punës nën juridiksionin e gjykatave të përgjithshme. Ky mungesë e specializimit ka rezultuar në procese të gjata dhe shpeshherë në mungesë të rezultateve të kënaqshme për palët e përfshira.

Mosrealizimi i këtyre nismave reformuese reflekton një mungesë të koordinimit të politikave qeveritare, veçanërisht në lidhje me prioritetet si drejtësia administrative dhe marrëdhëniet e punës. Për më tepër, kjo situatë ka shkaktuar sfida për qytetarët dhe punonjësit, të cilët shpesh detyrohen të përballen me mosmarrëveshje të zgjata dhe të kushtueshme në gjykatat aktuale.

Në përmbledhje, ndërsa Ligji për Gjykatën Administrative ka arritur deri në fazën e shqyrtimit në Gjykatën Kushtetuese, dhe për Gjykatën e Punës nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret, këto vonesa theksojnë nevojën urgjente për një përkushtim më të madh institucional dhe një koordinim më të mirë të politikave për të përmbushur reformat e planifikuara. Nëse këto çështje nuk trajtohen me prioritet, pasojat do të vazhdojnë të rëndojnë mbi qytetarët dhe bizneset që kërkojnë qasje të shpejtë dhe të drejtë në drejtësi.

DËSHTIM

PRIORITETI QEVERITAR	GJENDJA FAKTIKE	SHKALLA E REALIZIMIT
<p>KODI CIVIL</p> <p><i>(2.2.2 Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative, fq. 13)</i></p>	<p>Kodi Civil i Republikës së Kosovës është një nismë legjislative e rëndësishme që synon të rregullojë dhe harmonizojë dispozitat ligjore të së drejtës civile në vend. Procesi i hartimit të këtij Kodi ka filluar në vitin 2014, me qëllim modernizimin e sistemit ligjor dhe përafrimin me standardet evropiane.</p> <p>Më 29 dhjetor 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Projektkodin Civil dhe e procedoi atë për miratim në Kuvendin e Kosovës. Megjithatë, Kuvendi nuk arriti ta miratojë këtë projektligj, pasi ai nuk mori mbështetjen e mjaftueshme, duke reflektuar mospajtime të brendshme dhe mungesë konsensusi politik, madje brenda vetë partisë në pushtet.</p> <p>Pas këtij dështimi, Ministria e Drejtësisë deklaroi se do të riprocedojë Projektkodin Civil në Kuvend, me synimin për miratimin e tij sa më parë. Megjithatë, përkundër premtimeve, miratimi i Kodit Civil u shty, pa ndonjë arsytim të qartë nga ana e qeverisë. Kjo shtyrje tregon për sfida të vazhdueshme në arritjen e konsensusit politik dhe adresimin e çështjeve kontestuese brenda projektligjit.</p>	 <p>DËSHTIM</p>
<p>INSTITUTI PËR KRIMET E KRYERA GJATË LUFTËS NË KOSOVË</p> <p><i>(2.2.3 Adresimi i gjenocidit dhe krimeve të kryera gjatë luftës dhe vlerave të mbrojtura me të drejtë ndërkombëtare, fq. 14)</i></p>	<p>Instituti për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë u themelua në bazë të Ligjit Nr. 08/L-177, i cili hyri në fuqi në fund të gushtit të vitit 2023. Ky institut ka për qëllim dokumentimin dhe hulumtimin e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe veprimeve gjenocidale të kryera gjatë periudhës 1998-1999. Përmes punës së tij, synohet ruajtja e kujtesës historike dhe krijimi i një baze të fuqishme për kërkesat për drejtësi.</p> <p>Më 17 dhjetor 2024, Instituti publikoi raportin e tij të parë vjetor, duke njoftuar grumbullimin e rreth 190 metra material arkivor fizik dhe rreth 15 terabajt material digjital, që përfshijnë video, audio dhe fotografi të periudhës së luftës në Kosovë. Materialet janë mbledhur nga 67 burime të ndryshme, me qëllim të shërbimit si një burim për kujtesën kolektive dhe proceset e drejtësisë.</p> <p>Megjithatë, analiza më e detajuar e këtyre të dhënave vë në dyshim nivelin e suksesit të arritur nga Instituti. Nëse i përkthejmë 190 metra material arkivor fizik në faqe A4, kjo korrespondon me rreth 640 faqe, një rezultat që nuk mund të konsiderohet një arritje e madhe për një vit punë.</p> <p>Edhe për arkivin elektronik, informacioni i dhënë se është mbledhur 15 terabajt video material, është diskutabil pasi që informacioni i saktë dhe i drejtë do të duhej të ishte se sa orë video material është mbledhur, duke marrë parasysh rëndësinë e dokumentimit të krimeve të luftës.³</p> <p>Këto të dhëna tregojnë se promovimi i arritjeve të Institutit nga ana e Qeverisë është më shumë një strategji për të krijuar përshtypje sesa një reflektim i vërtetë i punës së kryer. Në të ardhmen, është e domosdoshme që raportimet për progresin të jenë më transparente dhe objektive, duke pasqyruar saktësisht shkallën e arritjeve dhe sfidave me të cilat përballlet Instituti.</p>	 <p>E REALIZUAR</p>

³ <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/prezantohet-raporti-1-vjecar-i-institutit-te-krimeve-te-kryera-gjate-luftes-ne-kosove/>

**PRIORITETI
QEVERITAR**
GJENDJA FAKTIKE
**SHKALLA E
REALIZIMIT**
**PADIA KUNDËR
SERBISË PËR
GJYKATËN
NDËRKOMBËTARE TË
DREJTËSISË**

(2.2.3 Adresimi i gjenocidit dhe krimeve të kryera gjatë luftës dhe vlerave të mbrojtura me të drejtë ndërkombëtare, fq. 14)

Qeveria e Kosovës ka shpallur përgatitjen e padisë për gjenocid kundër Serbisë si një prioritet strategjik, por deri më tani hapat konkretë për realizimin e saj kanë qenë të kufizuar dhe të paqarta. Edhe pse përgatitja e padisë është përfshirë në programin qeverisës 2021–2025, qasja e ndjekur duket se ka munguar në efikasitet dhe transparencë.

Procesi është paraqitur si kompleks, duke përfshirë mbledhjen e dëshmimeve dhe bashkëpunimin me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë. Megjithatë, Ministria e Drejtësisë dhe institucionet përkatëse nuk kanë dhënë detaje specifike mbi përparimin konkret të kësaj pune. Mbajtja e procesit konfidencial është justifikuar me ndjeshmërinë e çështjes, por kjo mungesë e transparencës ka krijuar pasiguri dhe skepticizëm për seriozitetin e angazhimit të qeverisë në këtë iniciativë.

Qeveria ka deklaruar se padia është afër finalizimit, por pa dhënë informacione të qarta për hapat e ardhshëm. Në anën tjetër, disa ekspertë juridikë kanë paralajmëruar sfida serioze, përfshirë mungesën e juridiksionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për një padi të tillë, duke pasur parasysh se Kosova nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara.

Mungesa e qartësisë dhe koordinimit të qeverisë për këtë iniciativë ngre pikëpyetje për përgatitjet reale që janë bërë. Deri tani, nuk ka pasur raportime konkrete mbi grumbullimin e dëshmimeve të reja apo një strategji të mirëpërcaktuar juridike që do të mbështeste një padi të suksesshme. Për më tepër, qasja e përdorur nga qeveria duket se është më shumë simbolike sesa një përpjekje serioze për të ndjekur drejtësinë për viktimat e luftës.

Për fund, derisa padia për gjenocid përfaqëson një hap të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për drejtësinë historike dhe morale, mënyra si po trajtohet aktualisht nga qeveria lë shumë për të dëshiruar. Mos finalizimi i saj deri më tani tregon mungesën e qasjes strategjike dhe përgatitjes së nevojshme, duke reflektuar një dështim të qartë nga ana e qeverisë për ta realizuar këtë iniciativë jetike.

DËSHTIM
**DIGJITALIZIMI I
SHËRBIMEVE**

(2.2.4 Përmirësimi i shërbimeve të profesioneve të lira ligjore dhe digjitalizimi i sistemit të drejtësisë, fq. 14)

Ministria e Drejtësisë ka ndërmarrë disa hapa drejt digjitalizimit të shërbimeve noteriale, duke synuar përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës. Megjithatë, këto përpjekje mbeten të pjesshme. Për më tepër, është e rëndësishme të theksohet se këto iniciativa janë realizuar kryesisht me mbështetje nga donatorët ndërkombëtarë, duke ngritur pikëpyetje serioze mbi qëndrueshmërinë e tyre dhe angazhimin e plotë të institucioneve vendore.

Megjithatë, deri në momentin e hartimit të këtij raporti, digjitalizimi i shërbimeve për noterët dhe përmbaruesit privat nuk është finalizuar. Si rezultat, qytetarët dhe bizneset vazhdojnë të përballen me sfida burokratike, mungesë transparence dhe procese të ngadalta. Ky dështim për të përfunduar këto reforma tregon mungesën e një strategjie të qartë dhe vizionit afatgjatë për të përmirësuar qasjen në drejtësi dhe për të modernizuar shërbimet kyçe në këtë sektor.

DËSHTIM

Reformat në Financa Publike dhe Prokurim Publik

PRIORITETI QEVERITAR

GJENDJA FAKTIKE

SHKALLA E REALIZIMIT

Strategjia për financat publike (Ligji i ri për menaxhimin e financave publike)

(2.4.6 Reformat në financa publike dhe prokurim publik, fq. 22)

Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike të Republikës së Kosovës 2022-2026 është rezultat i një procesi të gjithanshëm dhe të koordinuar, që përfshiu institucionet kryesore shtetërore dhe partnerët zhvillimorë me synimin për të përmirësuar qëndrueshmërinë financiare dhe efikasitetin e shpenzimeve publike. Ky proces filloi me vlerësimin e gjendjes ekzistuese të menaxhimit të financave publike, ku pikat kryesore përfshinin sfidat në buxhetim, shpenzim, raportim financiar dhe kontrollin e brendshëm. Ky vlerësim u bazua në standardet dhe praktikatat më të mira të BE-së dhe udhëzimet e organizatave ndërkombëtare.

Hartimi i strategjisë u mbështet nga partnerë ndërkombëtarë, të cilët ofruan ekspertizë teknike dhe financiare.

REALIZUAR

Rishikimi i kornizës ligjore financat publike (Ligji i ri për menaxhimin e financave publike)

(2.4.6 Reformat në financa publike dhe prokurim publik, fq. 22)

Projektligji për Menaxhimin e Financave Publike, i paraparë të miratohej më 15 tetor 2024 sipas Programit Legjislativ të vitit 2024, nuk ka përfunduar dhe si rrjedhojë nuk është proceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, as për shqyrtim e miratim në Kuvend. Ky dokument, i konsideruar si një hap kyç për përmirësimin e menaxhimit të financave publike, mbetet pezull, duke ndikuar drejtpërdrejt në vonesën e reformave të planifikuara në këtë sektor. Mosrespektimi i afateve të përcaktuara tregon një mungesë serioze të përkushtimit për zbatimin e prioritetëve të parashikuara dhe ngre shqetësime mbi përgjegjshmërinë në nivel qeveritar.

Kjo vonesë ka implikime të rëndësishme. Së pari, ngadalësimi i reformave e lë sistemin e menaxhimit të financave publike të ekspozuar ndaj sfidave të vazhdueshme, përfshirë paefikasitetin, mungesën e transparencës dhe llogaridhënies në përdorimin e fondeve publike.

DËSHTIM

Rishikimi i kornizës ligjore për prokurim publik




(2.4.6 Reformat në financa publike dhe prokurim publik, fq. 22)

Projektligji për Prokurimin Publik, i cili ishte planifikuar të miratohej më 20 mars 2024 nga Qeveria, sipas Programit Legjislativ të vitit 2024, nuk është përfunduar. Për me tepër, ky projektligj ka qenë pjesë e programeve legjislative edhe gjatë viteve 2023, 2022 dhe 2021, gjë që dëshmon një mungesë të theksuar efikasiteti dhe një neglizhencë të vazhdueshme nga ana e Qeverisë. Kjo situatë është veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh se prokurimi publik është një nga sektorët më të ndjeshëm dhe më të ekspozuar ndaj korrupsionit.

Mosrealizimi i këtij projektligji dhe shtyrja e vazhdueshme e miratimit të tij nënkupton një mungesë të qartë të prioritizimit dhe përkushtimit ndaj reformave në këtë sektor kritik dhe tregon mungesë serioze të përgatitjes dhe koordinimit në nivel qeveritar. Ky dështim rrezikon jo vetëm reputacionin e institucioneve publike, por edhe kapacitetin për të adresuar problemet sistematike të lidhura me keqpërdorimet në prokurimin publik.

DËSHTIM

Ekonomia dhe Rimëkëmbja

PRIORITETI QEVERITAR	GJENDJA FAKTIKE	SHKALLA E REALIZIMIT
FONDI SOVRAN (1.2. Ringjallja ekonomike, fq. 9)	<p>Ligji për Fondin Sovran të Kosovës, një nismë kyçe për krijimin e një mekanizmi të qëndrueshëm për menaxhimin e asetëve shtetërore dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik, ka qenë në qendër të premtimeve nga partia në pushtet për disa vite. Qeveria kishte paralajmëruar miratimin e këtij ligji si një prioritet strategjik.</p> <p>Ligji për Fondin Sovran të Republikës së Kosovës u miratua nga Kuvendi më dhjetor 2023.</p> <p>Pas miratimit, partitë opozitare, e kontestuan ligjin duke e dërguar në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar se ligji është diskriminues dhe në kundërshtim me parimin e ekonomisë së lirë të tregut. Aktualisht, Gjykata Kushtetuese është duke shqyrtuar ligjin dhe ende nuk ka marrë një vendim përfundimtar.</p>	
BANKA ZHVILLIMORE E KOSOVËS (1.2. Ringjallja ekonomike, fq. 9)	<p>Krijimi i Bankës Zhvillimore në Kosovë - e prezantuar si një shtyllë e rëndësishme e politikës ekonomike të qeverisë aktuale që adreson nevojën për investime strategjike dhe mbështetjen e sektorit privat – ka mbetur vetëm një premtim bosh.</p> <p>Kjo ide ka qenë e paraqitur edhe në Programin e Qeverisë së Kosovës 2021-2025, si një hap i domosdoshëm për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe për të promovuar investime në sektorë strategjikë si bujqësia, energjia dhe prodhimi. Por pavarësisht rëndësisë së saj, jo vetëm që nuk është ndërmarrë asnjë hap drejt themelimit të saj, por nuk ka as një afat kohor të qartë apo një plan të detajuar për këtë projekt.</p>	
SHUARJA E AGJENCISË KOSOVARE PËR PRIVATIZIM (1.2. Ringjallja ekonomike, fq. 9)	<p>Shuarja e Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka qenë temë bosht si hap i parë për rimëkëmbje ekonomike të vendit. Mirëpo, Agjencia Kosovare e Privatizimit gjatë katër viteve të fundit, ka vazhduar procesin e privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, duke realizuar shitjen e asetëve kryesisht përmes metodës së likuidimit si dhe ka publikuar lista përfundimtare për përfitimin e 20% të të hyrave nga shitjet e asetëve.</p> <p>Shuarja e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, krijimi i një Fondi Sovran dhe i Bankës Zhvillimore kanë qenë tre shtyllat kryesore të programit ekonomik të Lëvizjes Vetëvendosje. Këto nisma janë prezantuar si hapa transformues për ekonominë e Kosovës, duke synuar përmirësimin e menaxhimit të asetëve publike, nxitjen e investimeve strategjike dhe fuqizimin e zhvillimit ekonomik.</p> <p>Megjithatë, deri më sot, asnjëra prej këtyre nismave nuk është jetësuar që tregon një nivel të ulët të performancës dhe koordinimit strategjik në ekonomi, duke lënë një hendek midis objektivave të deklaruara dhe rezultateve reale.</p>	

Sektori i Edukimit

PRIORITETI QEVERITAR

GJENDJA FAKTIKE

SHKALLA E REALIZIMIT

REFORMAT NË ARSIM

(2.15
Arsimi dhe
Shkenca,
fq. 42.)

Qeveria e Kosovës ka identifikuar gjashtë fusha kryesore të transformimit për zhvillimin e arsimit: edukimin parashkollor, tekstet e reja shkollore, shkollimin profesional, sistemin e bursave, arsimin e lartë pa pagesë dhe themelimin e një fondi për hulumtime shkencore. Pavarësisht ambicies së këtyre masave, qasja e propozuar ngre shqetësime për realizueshmërinë dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e sistemit arsimor.

Projekti për edukimin parashkollor parashikon ofrimin e qendrave edukative në çdo komunë, me lehtësira për kategori të caktuara të popullsisë. Megjithatë, mungesa e një plani të detajuar financiar dhe operacional për këtë komponentë lë hapësirë për dyshime mbi efektivitetin e tij. Në shumë komuna, infrastruktura ekzistuese dhe kapacitetet administrative mbeten të pamjaftueshme për zbatimin e këtij objekti.

Përmirësimi i teksteve shkollore është përmendur si një prioritet për avancimin e arsimit para universitar dhe përgatitjen për shkolla digjitale. Sidoqoftë, proceset e kaluara për hartimin dhe aprovimin e teksteve kanë treguar vonesa dhe probleme të cilësisë, të cilat nuk janë adresuar si duhet në planifikimin e ri. Në mungesë të një reforme gjithëpërfshirëse për përmbajtjen mësimore, kjo masë rrezikon të jetë thjesht objektivë kozmetike.

Shkollat profesionale janë identifikuar si një shtyllë për përgatitjen e fuqisë punëtore për tregun e punës. Planin për t'i modernizuar ato mbetet i paqartë në lidhje me profilizimin, burimet financiare dhe bashkëpunimin me sektorin privat. Për më tepër, strategjitë e kaluara për arsimin profesional nuk kanë arritur të krijojnë lidhje efektive me nevojat e tregut, gjë që rrezikon të përsëritet edhe në këtë fazë.

Planin i Qeverisë parashikonte krijimin e bibliotekave për mësimdhënësit me literaturë bashkëkohore, madje edhe **ofrimin e banimit me kosto të përballueshme** dhe një model për vlerësimin dhe shpërblimin e performancës së tyre. Megjithatë, mungesa e detajeve për financimin, zbatimin dhe monitorimin e këtyre masave ngre shqetësime mbi realizueshmërinë dhe efektivitetin e tyre, veçanërisht në zonat rurale dhe për sigurimin e barazisë. Pa plane konkrete, këto propozime rrezikojnë të mbeten premtime të përcaktuara.

Arsimi i lartë pa pagesë është realizuar por në praktikë, sistemi i arsimit të lartë në Kosovë vuan nga mungesa e financimit të qëndrueshëm dhe nga kapacitetet e dobëta për kërkim shkencor.

Përkundër ambicies së Strategjisë së Arsimit 2022-2026, implementimi i saj përballet me sfida të mëdha. Korniza ligjore e arsimit në Kosovë mbetet një sfidë serioze. Ligji mbi Edukimin në Fëmijërinë e Hershme është miratuar. Ligji mbi Arsimin Para Universitar ka nevojë për rishikim të thellë, ndërsa legjislacioni mbi arsimin dhe aftësimin profesional dhe arsimin e të rriturve duhet të unifikohen dhe përditësohen për t'iu përshtatur nevojave aktuale të tregut të punës. Ligji mbi Arsimin e Lartë mbetet pezull për vite për shkak të kërkesave specifike për votim (votimi i dyfishtë).


Për të siguruar që reformat të mos mbeten vetëm në letër, është thelbësore që të adresohet urgjentisht kapaciteti institucional për zbatim, si dhe të ndërtohet një dialog më efektiv me partnerët ndërkombëtarë dhe aktorët vendorë.

Fakti se në testin PISA 2022, Kosova është renditur ndër vendet e fundit nga 80 shtete pjesëmarrëse, duke zënë vendin e 76-të në lexim, 77-të në shkencë dhe 74-të në matematikë, tregon një situatë alarmante në sistemin arsimor të vendit. Rënia prej 11 pikësh në lexim dhe matematikë dhe 8 pikësh në shkencë krahasuar me vitin 2018 është një tregues i qartë i përkeqësimit të cilësisë së arsimit dhe mungesës së reformave efektive. Këto rezultate reflektojnë dobësi serioze në sistemin arsimor, duke përfshirë mungesën e qasjes së duhur në burime, kualitetin e mësimdhënies dhe mungesën e fokusit në zhvillimin e aftësive kritike të nxënësve.



DËSHTIM

Politika e Jashtme

PRIORITETI QEVERITAR	GJENDJA FAKTIKE	SHKALLA E REALIZIMIT
INTEGRIMI EUROPIAN DHE NATO	<p>Bashkimi Evropian</p> <p>Kosova ka aplikuar për anëtarësim në BE, një hap që kishte për qëllim të forconte pozicionin ndërkombëtar të vendit dhe të siguronte një perspektivë më të qartë evropiane. Megjithatë, reagimi i BE-së ndaj këtij aplikimi ka qenë indiferent, duke mos dhënë asnjë përgjigje zyrtare.</p> <p>Për më tepër, situata është përkeqësuar me vendosjen e masave kufizuese nga BE-ja ndaj Kosovës, përfshirë pezullimin e fondeve financiare. Ky është një zhvillim i paprecedent që nga shpallja e pavarësisë dhe sinjalizon tensionet e vazhdueshme ndërmjet Kosovës dhe disa vendeve anëtare të BE-së.</p> <p>Masat kufizuese nga BE-ja janë vendosur në kontekstin e menaxhimit të krizave në veri të Kosovës, ku institucionet e Kosovës janë kritikuar për qasjen e tyre. BE-ja e ka interpretuar këtë si një sfidë ndaj stabilitetit rajonal, ndërsa qeveria e Kosovës ka dështuar të sigurojë mbështetje diplomatike dhe të qetësojë tensionet.</p> <p>Në anën tjetër, marrëveshja e fundit për Planin e Rritjes midis Kosovës dhe BE-së, që ofron fonde të konsiderueshme për zhvillimin e vendit, përbën një aranzhim të kushtëzuar. Kjo do të thotë që janë disa kushte strikte që Kosova duhet t'i plotësojë, dhe mos respektimi i këtyre kushteve rezulton në humbjen e këtyre fondeve.</p>	
	<p>KËSHILLI I EVROPËS</p> <p>Në lidhje me Këshillin e Evropës (KiE), dështimi i Kosovës për të siguruar anëtarësimin jo vetëm që tregon dobësinë diplomatike të vendit, por përbën edhe një humbje të rëndësishme të një momenti historik për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës.</p> <p>Ky zhvillim ka dëmtuar seriozisht përpjekjet për konsolidimin e pozicionit të Kosovës si një shtet i njohur nga një organizatë shume e rëndësishme ndërkombëtare dhe ka nxjerrë në pah kufizimet e saj në ndërtimin e aleancave strategjike.</p> <p>Pavarësisht se disa shtete anëtare të KiE-së nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës, institucionet kosovare kanë pasur garanci të mëdha dhe të unifikuar për të siguruar mbështetjen e mjaftueshme. Megjithatë, vendimi i qeverisë për moa ta dërguar Statutin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Gjykatën Kushtetuese, është parë si një përpjekje për të shtyrë zgjidhjen e çështjes. Kjo ka krijuar një mungesë të besimit të partnerët ndërkombëtarë dhe ka rezultuar me mos anëtarësim në KiE.</p>	

NATO

Në raport me NATO-n, Kosova ka pësuar një regres të ndjeshëm. Përrjashtimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) nga pjesëmarrja në stërvitjen ushtarake "Defender Europe '23" ka qenë një goditje e madhe për përpjekjet e Kosovës për t'u integruar më tej në strukturat euroatlantike. Përkundër faktit se Kosova ishte nikoqire e kësaj stërvitjeje, ambasadori amerikan në Prishtinë deklaroi se pjesëmarrja e Kosovës në këtë aktivitet ka përfunduar për shkak të tensioneve politike dhe veprimeve të papërgjegjshme nga institucionet kosovare.

Këto zhvillime dëshmojnë një mungesë të koordinimit politik dhe diplomatik nga ana e Kosovës, duke vënë në pah sfidat serioze në ndërtimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe përmbushjen e objektivave strategjike. Për të përmirësuar situatën, Kosova duhet të përqendrohet në zbatimin e reformave të nevojshme, të angazhohet me më shumë seriozitet në dialogun me partnerët ndërkombëtarë dhe të forcojë kapacitetin e saj institucional për të menaxhuar krizën dhe për të përmbushur detyrimet ndërkombëtare.

NJOHJE TË REJA TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Që nga shpallja e pavarësisë më 17 shkurt 2008, Republika e Kosovës ka punuar vazhdimisht për të forcuar pozicionin e saj ndërkombëtar, duke synuar njohje të reja diplomatike dhe integrim në organizata ndërkombëtare. Këto përpjekje janë konsideruar një element kyç i politikës së saj të jashtme, me qëllim sigurimin e sovranitetit dhe njohjes së plotë ndërkombëtare.

Njohja e fundit e pavarësisë së Kosovës ka ndodhur më 1 shkurt 2021 nga Izraeli, pas marrëveshjes së Uashingtonit të nënshkruar më 4 shtator 2020. Që prej kësaj njohjeje të fundit, nuk janë raportuar hapa konkretë apo indikacione të qarta që do të çonin drejt njohjeve të reja. Si rezultat, procesi i rritjes së njohjeve ka ngecur, dhe Kosova nuk ka arritur të sigurojë as edhe një (1) njohje të re në këtë mandat qeverisës.

RAPORTI ME SHQIPËRINË

(2.17.4 Thellimi i bashkëpunimit me Shqipërinë, fq. 53)

Marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë kanë qenë historikisht të ngushta, të bazuara në lidhje të forta kombëtare dhe kulturore. Megjithatë, në vitet e fundit, këto marrëdhënie kanë përjetuar sfida dhe tensione të ndryshme.

Një nga format kryesore të bashkëpunimit ka qenë mbajtja e mbledhjeve të përbashkëta ndërmjet qeverive dhe kuvendeve të të dyja vendeve. Për shembull, më 20 dhjetor 2024, u mbajt një mbledhje e përbashkët e kuvendeve të Kosovës dhe Shqipërisë, e cila synonte forcimin e bashkëpunimit parlamentar dhe strategjik.

Megjithatë, kjo përpjekje për forcimin e bashkëpunimit u parapri **nga anulimi i takimit të përbashkët të qeverive në qershor 2023**, një ngjarje që shënoi një moment të tensionuar dhe mungesë të koordinimit mes dy palëve.

Në vitet e fundit, janë vërejtur tensione dhe mungesë koordinimi në çështje kyçe rajonale dhe ndërkombëtare. Qasjet e ndryshme ndaj dialogut Kosovë-Serbi dhe qëndrimet kundrejt iniciativave rajonale, si "Ballkani i Hapur", kanë thelluar ndasitë midis dy qeverive, duke ndikuar negativisht në raportet ndërmjet dy vendeve.

Megjithëse ekzistojnë përpjekje për të forcuar marrëdhëniet mes Kosovës dhe Shqipërisë, përfshirë nënshkrimin e disa marrëveshjeve në fusha si ekonomia, arsimit dhe energjia, zbatimi i tyre ka qenë i ngadalshëm dhe shpesh i pamjaftueshëm. Sfidat e fundit tregojnë nevojën për një angazhim më të madh politik dhe institucional për të adresuar tensionet dhe për të zbatuar në mënyrë efektive marrëveshjet e arritura. Një qasje më strategjike dhe e koordinuar është thelbësore për të tejkaluar sfidat dhe për të forcuar partneritetin e ndërsjellë.



DËSHTIM

ROLI I MËRGATËS NE PROMOVIMIN E KOSOVËS

(2.17.5 Rritja e rolit të mërgatës në zhvillimin dhe promovimin e vendit, fq. 53)

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) ka ndërmarrë "hapa për të përmirësuar imazhin ndërkombëtar" të Kosovës përmes angazhimit të konsulentëve dhe kompanive të specializuara. Përzgjedhja e individëve dhe firmave me profil të paqartë dhe mungesa e transparencës në procesin e kontraktimit kanë ngritur pikëpyetje mbi efektivitetin e këtyre përpjekjeve.

Për shembull, angazhimi i Gani Jakupit si konsulent i jashtëm për çështje kulturore dhe mediatike, me një pagesë mujore prej 7,500 euro, ka ngjallur reagime në opinionin publik. Fillimisht, MPJD e klasifikoi kontratën si konfidenciale, duke u thirrur në Ligjin për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë. Pas presionit publik, ministria publikoi kontratën, duke theksuar se shumica e kompensimit përfshin të gjitha shpenzimet e lidhura me përmbushjen e detyrave, duke përfshirë kostot jetësore dhe shpenzimet e tjera profesionale në Bruksel.

Në një rast tjetër, MPJD ka kontraktuar dy kompani për shërbime lobimi në SHBA: Ambal LLC dhe Afërdita Rakipi Communications, secila me një kontratë prej 147,000 euro. Raportet tregojnë se këto dy kompani kanë kryer aktivitete të ngjashme, duke kontaktuar të njëjtët politikanë amerikanë për të diskutuar mbi të njëjtat çështje në të njëjtat ditë, duke ngritur shqetësime për dublimin e përpjekjeve dhe efikasitetin e shpenzimeve.

Këto shembuj sugjerojnë se angazhimi i konsulentëve dhe kompanive me prapavijë të paqartë dhe mungesa e transparencës në procesin e përzgjedhjes janë duke minuar përpjekjet e MPJD-së për të përmirësuar imazhin ndërkombëtar të Kosovës.



DËSHTIM

3. Përfundim

Programi qeverisës duhet të jetë i bazuar në një qasje të mirëorganizuar, realiste dhe larg premtimeve të paarsyeshme apo të vështira për t'u realizuar në praktikë. Një planifikim i tillë kërkon analizë të thelluar të burimeve financiare dhe njerëzore, si dhe një vlerësim të rreziqeve të mundshme gjatë zbatimit. Gjithashtu, është thelbësore që qeveria të jetë transparente dhe e përgjegjshme para qytetarëve, duke u bazuar në ligjshmëri dhe kushtetutshmëri. Çdo politikë publike duhet të hartohet duke marrë në konsideratë si pasojat afatshkurtra, ashtu edhe ato afatgjata, në mënyrë që të jetë i qëndrueshëm dhe i dobishëm për zhvillimin ekonomik e social të vendit.

Në këtë këndvështrim, disa nga objektivat e paraqitura në program duhet të rishikohen ose të formësohen më mirë. Për shembull, iniciativat që lidhen me vettingun dhe fondin sovran, duhet të përpunohen më hollësisht për t'u siguruar se zbatimi i tyre do të jetë i mbështetur në normat kushtetuese, si dhe në një kornizë ligjore të qartë e funksionale. Vetëm kështu mund të garantohet një proces i drejtë dhe efektiv, që nuk bie ndesh me parimet e shtetit ligjor. Po ashtu, në aspektin praktik, propozime si krijimi i fondit të sigurimeve shëndetësore apo shuarja e Agjencisë së Privatizimit duhet të analizohen me kujdes, në mënyrë që të përcaktohet impakti i tyre i vërtetë në rritjen e cilësisë së shërbimeve, në mundësitë e punësimit apo në mbarëvajtjen e procesit të privatizimit. Kjo kërkon jo vetëm ekspertizë profesionale, por edhe konsultim të gjerë publik, në mënyrë që vendimmarrja të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme.

Një tjetër element i rëndësishëm lidhet me ritmin dhe mënyrën e zbatimit të këtyre masave dhe reformave. Një qeveri e përgjegjshme duhet të planifikojë hapat kryesorë që në fillim të mandatit, duke i shtrirë objektivat në mënyrë graduale dhe duke i zbatuar ato në çdo vit të qeverisjes. Një qasje e tillë siguron që progresi të jetë i matshëm, duke iu dhënë kohë institucioneve për të përvetësuar ndryshimet ligjore, strukturore dhe administrative. Përkundrazi, përqendrimi i zbatimit vetëm në vitin e fundit të mandatit, me qëllimin për të krijuar përshtypjen se programi është përmbushur, shpesh çon në nisma të pamenduara mirë ose me ndikim të kufizuar në realitetin ekonomik dhe social.

Po ashtu, balancimi midis qëndrueshmërisë fiskale dhe nevojave urgjente të qytetarëve duhet të jetë një prioritet kyç. Një plan i mirëstudjuar kërkon që të parashikohen kostot e projekteve kryesore dhe të sigurohen burimet e nevojshme financiare, pa rrezikuar stabilitetin makroekonomik. Për këtë qëllim, duhen forcuar institucionet e mbikëqyrjes financiare dhe mekanizmat e llogaridhënies, në mënyrë që përdorimi i fondeve publike të jetë sa më efikas dhe transparent. Vetëm përmes një qasjeje të tillë të integruar dhe të mirëstrukturuar, qeveria mund të ndërtojë besim ndër qytetarët dhe të arrijë rezultatet e pritshme në çdo fushë të qeverisjes.

Në përfundim, është thelbësore që çdo politikë apo reformë e programit qeverisës të bazohet në principet e racionalitetit, ligjshmërisë dhe realizueshmërisë praktike. Hartimi i detajuar, zbatimi i kujdesshëm dhe matja transparente e rezultateve krijojnë bazën për sukses dhe garantojnë që interesat e përgjithshme të vendit të jenë gjithnjë në plan të parë. Një program i tillë do të sigurojë jo vetëm përmbushjen e angazhimeve të marra, por edhe do të kultivojë një marrëdhënie besimi dhe bashkëpunimi mes qeverisë dhe qytetarëve.

